

VENDIM
Nr. 862, datë 20.12.2006

**PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES”
SHA**

(Ndryshuar me VKM nr. 436, datë 8.4.2008; nr. 218, datë 6.3.2009)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, dhe të nenit 33 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a. të ndajë divizionin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe të krijojë shoqërinë “Operatori i sistemit të shpërndarjes” (OSSH) sh.a.

2. Operatori i sistemit të shpërndarjes (OSSH) sh.a. ka kapital 100 për qind shtetëror, me aksionar të vetëm KESH sh.a.

3. Objekti kryesor i veprimtarisë së OSSH sh.a. është të sigurojë, nga rrjeti i saj i shpërndarjes së energjisë elektrike, për zonat që mbulohen:

a) furnizimin dhe shitjen e energjisë elektrike të klientët tariforë, të lidhur me rrjetin e shpërndarjes, me përjashtim të klientëve të kualifikuar;

b) operimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të mjediseve dhe pajisjeve, në administrim të saj, në përputhje me kërkesat teknike;

c) menaxhimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike;

ç) zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, në përputhje me perspektivat e zhvillimit ekonomik dhe të ndryshimit të kërkesës në rajon ose në territor;

d) shërbime të tjera për klientët, të nevojshme për të përmbushur detyrimet ndaj tyre, sipas legjislacionit në fuqi.

4. KESH sh.a., me cilësinë e aksionarit të vetëm të OSSH sh.a., autorizohet të bëjë ndarjen e aseteve fikse dhe të llogarive financiare, që rrjedhin, për shoqërinë e krijuar, sipas këtij vendimi, në përputhje me bilancin e datës 31.12.2006.

5. KESH sh.a. gëzon të drejtën si pjesëmarrës në asetet e OSSH sh.a. deri në çastin e kalimit të tyre në kapitalin e shoqërisë së krijuar, me këtë vendim. Të drejtat dhe detyrimet më 31.12.2006 mbeten për llogari të KESH sh.a., *me përjashtim të pjesës së detyrimeve, që lidhen me huatë/ kreditë afatgjata nga donatorët e huaj, që janë, disbursuar dhe materializuar, dhe që do të materializohen në të ardhmen si pjesë e aseteve të OSSH sh.a.-së, në kuadër dhe në zbatim të projekteve e të marrëveshjeve përkatëse me kreditorët e huaj, sipas të cilave KESH sh.a.-ja do të mbetet në rolin e kredimarrësit ose të nënkredimarrësit, kur kredimarrëse është qeveria.*

Nga ky rregull bëjnë përjashtim kreditë, ndërmjet KESH, sh.a.-së, dhe Bankës Europiane të Investimit, në shumën 2,3 (dy presje tre) miliardë lekë, dhe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore, në shumën 2,68 (dy presje gjashtëdhjetë e tetë) miliardë lekë, sipas specifikimeve, të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, detyrimet e të cilave nuk do t'i transferohen OSSH, sh.a.-së.

5/1 Asetet në administrim të KESH sh.a.-së, që i kalojnë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), sha, të regjistrohen në pronësi të këtij operatori.

5/2. Pronësia e aksioneve të OSSH sh.a.-së, transferohet nga KESH sh.a.-ja, te Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

5/3. Asetet e financuara nga kreditë afatgjata, të përfunduara gjatë vitit 2008, nga KESH, sh.a., për OSSH, sh.a.-në, në shumën 1,1 (një presje një) miliard lekë, t'i transferohen Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

(OSSH), sh.a.-së, dhe të regjistrohen në pronësi të këtij operatori.

Autorizohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ta pasqyrojë këtë transferim në formën e uljes së kapitalit të KESH, sh.a.-së, dhe të rritjes së kapitalit të OSSH, sh.a.-së, përkatësisht në vlerën e përcaktuar më lart.

5/4. Detyrimet afatshkurtra, për blerjen e energjisë elektrike dhe tarifën e transferimit, që OSSH, sh.a., ka, respektivisht, ndaj KESH, sh.a.-së, dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), sh.a.-së, deri në shumën 1 (një) miliard lekë, të shuben dhe të pasqyrohen si rritje kapitali e OSSH, sh.a.-së.

Autorizohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të kryejë veprimet e nevojshme, për pasqyrimin e këtij veprimi.

5/5. Shuma prej 0,53 (zero presje pesëdhjetë e tre) miliardë lekë, që i korrespondon pagimit të huave afatgjata, në vitin 2008, nga KESH, sh.a., të pasqyrohet si rritje kapitali për OSSH, sh.a.-në.

Autorizohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të kryejë veprimet e nevojshme, për pasqyrimin e këtij veprimi.

6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

(Shtuar me VKM nr. 218, datë 6.3.2009)

Shtojca 1

Specifikimet e kredive:

1. Marrëveshja e kredisë (numër 3671) së zhvillimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e rristurimit dhe të rehabilitimit të sektorit të energjisë elektrike e datës 26 qershor 2002, në shumën ekuivalente me njëzet e katër milionë të drejta të veçanta të tërheqjes (SDR) (24 000 000) ose 2,68 miliardë lekë, në periudhë maturimi njëzet (20) vjet dhe interes të barabartë me Libor plus 0,75% e ratifikuar me ligjin numër 8941, datë 19.9.21002.

2. Marrëveshja e kredisë ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.) dhe Bankës Europiane të Investimit për projektin e përmirësimit të kapacitetit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes, e datës 30 tetor 2001, në shumën tridhjetë milionë euro (EUR) (30 000 000) ose 2.3 miliardë lekë, me periudhë maturimi tetëmbëdhjetë (18)vjet dhe interes të barabartë me Euribor plus 0.75%.